



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.99, datë 09.05.2023

PËR

“MIRATIMIN E SHKALLËS SË VLERËSIMIT TË KRITEREVE TË POSAÇME TË KANDIDATËVE PËR NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90 pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenet 47 pika 6 dhe 52 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 10, 11 pika 1, 22 germa “c” dhe 25 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shkallën e vlerësimit për çdo kriter të posaçëm dhe për secilin kandidat për drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si më poshtë:

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE			
		Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi	Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore	Aftësitë në ndërveprimin me median	Aftësi të tjera
1.	Elida Hoxhaj	Nivel i mesëm	Nivel i mesëm	Nivel i lartë	Nivel i ulët
2.	Eljon Mustafaj	Nivel i lartë	Nivel i mesëm	Nivel i lartë	Nivel i mesëm
3.	Suela Beluli	Nivel i mesëm	Nivel i mesëm	Nivel i lartë	Nivel i mesëm

2. Të mos vijojë procedurat për vlerësimin e posaçëm për kandidatin Genci Mane.
3. Të përfundojë procedurën e ngritjes në detyrën e drejtuesit për kandidatët Ervisa Hyka dhe Çlirim Sino.

4. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
8. U shpall në Tiranë, sot më 09.05.2023.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza